

AKT-THEMELUES
I
SHOQERISE "SAER PRODUCTION" shpk

Ne mbështetje të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjeve në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ortaku themelues :

Z. Samuele Vargu, identifikuar me ID nr. 037385611 madhor, me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar, sot me datë 19/01/2023 vendosi themelimin e Shoqërisë "SAER PRODUCTION" shpk.

FORMIMI
NENI 1

Formohet Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar "SAER PRODUCTION" shpk e cila do të funksionojë sipas ligjeve në fuqi dhe Statutit të Shoqërisë.

Me poshtë do të referohet si Shoqëria.

SELIA DHE ADMINISTRATORI
NENI 2

Selia e Shoqërisë është në adresën : Tirane, Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga "Themistokli Gërmenji", Nd.11, Shkalla 4, Ap.5., 1024 Tirane Shoqëria do të administrohet nga Administratori i Vetëm i Shoqërisë z. Samuele Vargu identifikuar me ID nr. 37385611 mandati i të cilit do të jetë 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

KOHEZGJATJA
NENI 3

Veprimtaria e shoqërisë do të zgjaset për një kohë të pacaktuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE
NENI 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Shtëpi kinematografike, për prodhimin, bashkëprodhimin dhe shpërndarjen në Shqipëri dhe jashtë kufijve të saj të filmave artistike të metrazhit të gjatë, të mesëm dhe të shkurter, i filmave dokumentare, filmave të animuar, filmave autor, televizivë dhe komercialë, si dhe programeve audio - vizuale në të gjitha format ekzistuese.

- Organizimi i aktiviteteve kinematografike, artistike dhe audio - vizuale në të gjitha format ekzistuese.

- Dhenia e asistencës teknike, artistike dhe organizative të nevojshme për prodhimin e filmave artistike të metrazhit të gjatë, të mesëm dhe të shkurter, të dokumentareve, filmave autorë, televizivë dhe komercialë dhe të programeve audio -vizuale (përfshirë skenën dhe televizionin) që do të prodhohen në Shqipëri dhe jashtë kufijve të saj.

- Konsulencë për prodhimin e filmave artistike të metrazhit të gjatë, të mesëm dhe të shkurter, të dokumentareve, filmave publicitare dhe të programeve audio -vizuale (përfshirë skenën dhe televizionin) që do të prodhohen në Shqipëri dhe jashtë kufijve të saj.

Organizimi i koncerteve apo spektakle të ndryshëm, me vete apo si bashkorganizator. Prodhimi dhe shitja e spoteve publicitare. Prodhimi dhe shitja e klipëve, videoklipëve të ndryshëm.

-Në përgjithësi, kryerja e çdo aktiviteti tjetër që shoqëria do të konsiderojë të arsyeshme

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të zgjerohet ose ndryshojë me vendim të ortakeve themelues të shoqërisë.

Shoqëria mund të blejë e të shesë kuota ose aksione në shoqëri të treta, si në mënyrë të ashtu edhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj si dhe të marrë pjesë në konsorciume të ndryshme me shoqëri të tjera për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta.



KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise "SAER PRODUCTION" shpk është 100 (njëqind leke). Kapitali është i ndare në 1 (një) pjesë, me vlerë nominale 100 (njëqind) leke që përben 1 kuotë.

Kapitali themeltar është nënshkruar tërësisht nga Ortaku themelues.

NENI 6

Ndarja e fitimit do të jetë 100 (njëqind) përqind në favor të ortakut themelues të shoqerise sipas pjesëmarrjes së kuotave.

NENI 7

Përsa nuk përcaktohet me siper, për bazë referimi do të meren ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë si dhe Statuti i shoqerise.

NENI 8

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe secila me vlerë të njëjtte ligjore.

Hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga ortakut i vetëm themelues i shoqerise « SAER PRODUCTION » shpk.

**ORTAKU THEMELUES
SAMUELE VARGU**

SAMUELE VARGU

